



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.02-41
13.02.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 41, paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe Njoftimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup PA1 nr.02-41 datë 07.02.2025, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr. 02-599/2 datë 12.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 6-të mbajtur më 11.02.2025, miratoi si vijon:

PROPOZIM - VENDIM

1. LEJOHET ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, përkatësiht:

- për heqjen e personit fizik Gordana Andreevska, me NVAQ 2101974455143 dhe adresë në rr. „Metodija Andonov – Çento“ nr. 10/1-6, Shkup, me pjesëmarrje prej 100% në kapitalin bazë të transmetuesit dhe

- për hyrjen e personit fizik Nikolla Tasev, me NVAQ 0101975483003 dhe adresë në rr. „Simeon Kavrakirov“ nr. 29/1-14, Shkup, me pjesëmarrje prej 100% në kapitalin bazë të transmetuesit.

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, pas ndryshimit të kryer, paraqitur në pikën 1 të këtij vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të dorëzoj gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, detyrohet të zbatojë ndryshim në strukturën e pronësisë nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita e pranimet të këtij Vendimi. Në të kundërtën, pas skadimit të afatit të caktuar, Vendimi nuk jep efekt juridik.

4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV MTM SHPKNJP Shkup, në përputhje me nenin 41, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

së Maqedonisë“ nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-41 datë 07.02.2025), ka njoftuar Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e zbatimit të ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR MTM SHPKNJP Shkup.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-41 datë 07.02.2025) nga SHTR TV MTM SHPKNJP Shkup, u përcaktua se është i kompletuar dhe i rregullt, përkatësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë.

Agjencia, me qëllim që të hetojë nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR TV MTM SHPKNJP Shkup do të krijojnë koncentrim të paligjshëm mediatik, përkatësisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, përmes Sistemit të Shpërndarjes së Internetit të Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), siguroj Informacion për subjektet e ndërlidhur (persona të autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendja aktuale“, nr.0820-50/150020250044520, nr.0820-50/150020250044527 dhe nr.0820-50/150020250044536, të gjitha nga data 10.02.2025, nga ku shihet qartë se personi Nikolla Tasev figuron si person i autorizuar i FEDERATËS SË HOKEKIT TË MAQEDONISË Shkup, veprimtari prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 93.12 – Veprimtari e klubeve sportive, dhe si ortak në Shoqërinë për tregti dhe shërbime CVETNA AKADEMIJA SHPKNJP Shkup, veprimtari prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 47.76 – Tregti me pakicë me lule, fidanë, fara, plehra, kafshë shtëpiake dhe ushqimi për kafshët në dyqane të specializuara. Personat juridik të lartpërmendur nuk figurojnë si themelues të Shoqërive Tregtare.

Gjithashtu, Agjencia ka kryer kontroll dhe në Regjistrin e pronarëve përfitues (të vërtetë) që udhëhiqet nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku është marrë dokumenti „Gjendja vijuese për personin fizik – pronar i vetëm“, nr.2007-50/150020250044551 datë 10.02.2025, ku shihet se personi fizik Nikolla Tasev është evidentuar si pronar i vetëm i FEDERATËS SË HOKEKIT TË MAQEDONISË Shkup dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime CVETNA AKADEMIJA SHPKNJP Shkup.

Pas ndryshimit të kryer të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i SHTR TV MTM SHPKNJP Shkup, do të jetë personi fizik Nikolla Tasev, me NVAQ 0101975483003 dhe adresë në rrugën. „Simeon Kavrakirov“ nr. 29/1-14, Shkup, me pjesëmarrje prej 100% në kapitalin bazë të transmetuesit.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV MTM SHPKNJP Shkup, detyrohet që të zbatoj ndryshim në strukturën e pronësisë nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita e pranimit të këtij Vendimi. Në të kundërtën, pas skadimit të afatit të caktuar, Vendimi nuk jep efekt juridik.

Duke qenë se Agjencia ka konstatuar se me zbatimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR TV MTM SHPKNJP Shkup nuk krijohet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, përkatësisht se ndryshimi në fjalë nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë PA1 nr.02-41 datë 07.02.2025, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse është i pakënaqur me vendimin, ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të parashtron padi për inicimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.